



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:295881

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05838872

C.nr.1529/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve: B.N nga Rahoveci, N.B nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit dhe J.Sh nga fshati Prapaqan, Komuna e Deçanit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson A.M, avokat nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Rahovec, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2.318.85 euro, jashtë seance, më datën 20.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve: B.N, N.B dhe J.Sh.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.N nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 187.27 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Nëntor 2022 në shumën prej 585.68 euro, në shumën e përgjithshme prej 772.95 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 18.12.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N.B nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 187.27 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Nëntor 2022 në shumën prej 585.68 euro, në shumën e përgjithshme prej 772.95 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 18.12.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit J.Sh nga fshati Prapaqan, Komuna e Deçanit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 187.27 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Nëntor 2022 në shumën prej 585.68 euro, në shumën e

përgjithshme prej 772.95 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 18.12.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve B.N, N.B dhe J.Sh, ti paguaj shumën prej 228.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit: B.N nga Rahoveci, N.B nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit dhe J.Sh nga fshati Prapaqan, Komuna e Deçanit, në këtë gjykatë me datë 18.12.2023, përmes të autorizuarit të tyre A.M, avokat në Rahovec, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të nenit 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 22.01.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërsi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 03.06.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Paditësit kanë parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 18.12.2023, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditësve është parashkruar në tërsi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shumë se 3 vite. Paditësit nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësve pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësit të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SH.M.L.P “ Selajdin Mullaabazi-Mici”, në Rahovec. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019- 2022 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve B.N, N.B dhe J.Sh, është në shumën prej 459.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%.

Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve: B.N, N.B dhe J.Sh, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 12.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 18.12.2023, ndërsa kërkesëpafia e paditësit përfshin periudhën kohore deri me datën 31.11.2022, e që është brenda afatit kohor 3 vjeçar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit

“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.*

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 208.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 290.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.1529/2023, më datën 20.06.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën